



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Flori Rexhepi</b>	<b>24.05.2023</b>	<b>02.06.2023</b>	<b>2023/0291</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.05.2023, OE “” Enggroup ” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0291, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE” me nr. të prokurimit: "214-23-1131-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 90,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 03.03.2023, data e hapjes së ofertës: 27.03.2023 , data e njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues: 02.05.2023 , data e njoftimit të me letër standarde: 02.05.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1. Qëllimi

Neni 7. Barazia ne trajtim / Jo Diskriminimi

Neni 56. Dispozitat e përgjithshme për zgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave.

Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve.

Neni 60. Kriteret për dhenje të kontratës.

Neni 69. Aftësitë teknike / profesionale

#### KRITERET PËR VLERËSIM

Neni 61 i LPP-se.

#### RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Sipas raportit të vlerësimit të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë të përgjegjshëm.

#### INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Është kualifikuar sipas Nenit 4.1.26 të LPP-së.

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " Enggroup " SH.P.K.

### Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se pala e pakënaqur me vendimin e AK-Policisë se Kosovës për anulim të aktivitetit të prokurimit, ka parashtruar ankese ne OSHP, me datën: 19.05.2023, duke pretenduar me rastin e vlerësimit të ofertave Autoriteti kontraktues, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se:

- Çmimet e ofruara kanë qenë abnormalisht të ulta në krahasim me çmimet e parashikuara nga AK për këtë projekt. Edhe pse kemi kërkuar sqarim nga OE për këto çmime. Përgjigjet e kthyer nga OE për AK nuk kanë qenë bindëse.

Sa i përket arsyes se eliminimit të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron se Rregullorja për çmime Jo/Normalisht ulëta nuk mund të aplikohet për faktin se nga katër operatore ekonomik të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit vetëm dy janë të përgjegjshëm, përderisa kushti i pare për aplikim të rregullores për çmime jo normalisht të ulëta është që të jen tri oferta të përgjegjshme.

Autoriteti kontraktues, me date: 24.04.2023, në harmoni me nenin 61 të LPP-se i është drejtuar OE-ve, konkretisht OE ankues me kërkesë për sqarim të çmimit/pozicioneve.

OE ankues në përgjigje të kërkesës së AK-se, i ka dhënë faktet dhe argumentet e veta dhe njëherit edhe në ankesën e tij të parashtruar në OSHP, deklaron se i qëndron çmimit të dhënë në ofertën e tij financiare dhe se i njëjti deklaron që është i gatshme ta pranojë rritjen e sigurisë së ekzekutimit.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në dispozitat e nenit 61 të LPP-se, konkretisht paragrafit 4 të këtij neni, vlerëson se është e drejtë e autoritetit kontraktues vlerësimi i çmimeve, sepse në paragrafin 4 thuhet se:

61.4 Pasmarrjesparasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuarangatenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos të tenderi është jo-normalishti ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

Bazuar në sqarimet e dhënë me lartë në veçanti bazuar në paragrafin 4 të nenit 61 të LPP-se, eksperti shqyrtues vlerëson se, vlerësimi i çmimeve është e drejtë e autoritetit kontraktues, prandaj pretendimi OE ankues, për shkelje të dispozitave të LPP-se nuk qëndron.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"Enggroup " SH.P.K."**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE"** me numër të prokurimit: **"214-23-1131-2-2-1"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "' Enggroup " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "SHËRBIME PROFESIONALE INXHINJERIKE" me numër të prokurimit: "214-23-1131-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" Enggroup " SH.P.K.**

